

Nr. K1/L3-7 Prot.

Tiranë 04.11.2025

Nr. Dok. 202502677/6

Lënda: Rekomandime për përmirësimin e transparencës, komunikimit dhe procedurave administrative të trajtimit të aplikimeve për mbështetje të projekteve kulturore nga organizatat e pakicave kombëtare

BASHKISË TIRANË

Për dijeni:

KËSHILLI ARTISTIKO – KULTUROR PRANË BASHKISË TIRANË

QENDRA "LARALARA"
TIRANË
Tel: 0672050452

Pranë institucionit të Avokatit të Popullit është paraqitur një ankesë nga Qendra "Laralara" ndaj Bashkisë së Tiranës, konkretisht Drejtorisë së Kulturës, lidhur me mënyrën se si është trajtuar aplikimi i tyre për mbështetje financiare për festivalin "Tirana HarmoniFest – Edicioni II". Ankesa lidhet me mosrespektimin e afateve të shpallura zyrtarisht, mungesën e përgjigjes brenda një kohe të arsyeshme, si dhe me sjelljen përjashtuese dhe fyese që, sipas tyre, ka rezultuar në dështimin e organizimit të aktivitetit. Sipas Laralara, dokumentacioni për aplikimin është dorëzuar më 28 shkurt 2025, me qëllim që të shqyrtohej më 6 mars, siç parashikohej në njoftimet e Bashkisë. Përgjigja zyrtare ka munguar për javë të tëra, pavarësisht përpjekjeve të vazhdueshme të organizatës për të kontaktuar me Bashkinë përmes thirrjeve telefonike dhe mesazheve. Vetëm më 4 prill, katër ditë para datës së planifikuar të festivalit, është dërguar një email ku njoftohej se ishin miratuar disa zëra financiarë për mbështetje. Përfaqësuesit e Laralara e kanë konsideruar këtë si një njoftim të vonuar dhe të pavlefshëm, duke qenë se organizimi i një festivali të tillë nuk mund të realizohet brenda vetëm një dite pune, pasi data 8 prill ishte e martë dhe fundjava ndërmjet pengonte përgatitjet. Kërkesa për ta shtyrë datën dhe për të përdorur fondet për një aktivitet të ngjashëm më 6 maj, me rëndësi të veçantë për komunitetin rom, është refuzuar pa ndonjë arsye të mirëfilltë, me arsyetimin se fondet ishin miratuar vetëm për datën 8 prill. Sjellja e Bashkisë është konsideruar nga ankuesi jo vetëm si pengesë administrative, por si një akt përçmimi ndaj punës së një organizate që angazhon kryesisht anëtarë të komunitetit rom dhe që ka punuar që prej tetorit 2024 për organizimin e këtij festivali.

Pas regjistrimit të rastit dhe marrjes së çështjes për shqyrtim, Avokati i Popullit në respektim të detyrimeve ligjore që rrjedhin në zbatim të Kushtetutës dhe të ligjit, për garantimin e të drejtave, lirive themelore dhe interesave të shtetasve shqiptarë dhe atyre të huaj, nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike dhe të tretëve, që veprojnë për llogari të saj, ka konstatuar se ky rast plotëson të gjitha kushtet thelbësore të formës dhe të përmbajtjes për t'u konsideruar në kompetencën e tij lëndore, ndaj vendosëm marrjen në shqyrtim të tij dhe çeljen e hetimit administrativ.

Sa më sipër, për qëllime të hetimit administrativ lidhur me këtë rast, me shkresën nr. K1/L3-2, dt. 06.05.2025 Avokati i Popullit i është drejtuar Bashkisë Tiranë me kërkesë për informacion të plotë dhe gjithëpërfshirës lidhur me rrethanat e paraqitura në ankesë, përfshirë por pa u kufizuar në çështjet si vijon.

Procedura dhe transparenca institucionale

1. Cila është data e saktë e marrjes së aplikimit dhe dokumentacionit përkatës nga Qendra Laralara?
2. Cilat janë afatet e shqyrtimit të këtij aplikimi?
3. Cilat janë arsyet e vonesës në dhënien e përgjigjes zyrtare, duke qenë se ajo është bërë vetëm 4 ditë para datës së festivalit?
4. Pse nuk është komunikuar më herët as një përgjigje pozitive, negative apo ndërmjetëse për aplikimin, ndonëse aplikuesi ka deklaruar se ka kontaktuar në mënyrë të përsëritur përmes email-eve dhe telefonatave?
5. A ekziston një protokoll/rregullore apo akt tjetër që përcakton afatet dhe mënyrën e trajtimit të aplikimeve? Nëse po, të na vendoset në dispozicion.
6. A ekziston një mekanizëm anekse ose vlerësimi për rastet kur mbështetja jepet në kushte që pengojnë realizimin efektiv të aktivitetit?

Vlerësimi përmbajtësor dhe qasja ndaj grupeve të ndjeshme

1. Mbi ç'bazë është refuzuar kërkesa për shtyrjen e datës së përdorimit të fondeve për një aktivitet të ngjashëm brenda të njëjtit vit?
2. A janë marrë në konsideratë rrethanat e veçanta të festivalit dhe përfaqësimi i komunitetit rom në procesin e vendimmarrjes?
3. Çfarë masash zbaton Bashkia për të siguruar trajtim të barabartë ndaj organizatave që përfaqësojnë komunitete të marginalizuara?
4. Nëse konstatohet se ka pasur neglizhencë institucionale, a parashikohet ndonjë formë alternative mbështetjeje për Qendrën Laralara?

Me shkresën nr. 1764/1, dt. 26.05.2025 Bashkia Tiranë, në përgjigje të kërkesës së mësipërme të Avokatit të Popullit, ka përcjellë përgjigje zyrtare në të cilën parashtrohet se procedura është ndjekur sipas praktikave standarde dhe brenda kuadrit rregullator. Ajo konfirmon se aplikimi është protokolluar më 28 Shkurt dhe është shqyrtuar më 4 Prill, pasi për shkak të kohës së shkurtër të ardhjes së projektit dhe shqyrtimit të dokumentacionit, projekti nuk arriti të shqyrtohej në mbledhjen e muajit Mars. Projekti është miratuar dhe pas vendimit të Këshillit Artistiko-Kulturor njoftimi është bërë menjëherë në rrugë zyrtare, përmes emailit. Komunikimet jozyrtare nuk njihen si pjesë e procedurës dhe kërkesa për shtyrjen e datës nuk

është pranuar, pasi projekti ishte i lidhur drejtpërdrejt me një datë të caktuar: 8 prillin, Ditën Ndërkombëtare të Romëve. Bashkia thekson gjithashtu se ajo nuk është detyruesisht financuesi i vetëm i projekteve kulturore dhe se organizatat mund të vazhdojnë punën e tyre edhe pa mbështetje financiare publike.

Në vijim të përgjigjes së sipërcituar, Avokati i Popullit, me shkresën nr. K1/L3-5, dt. 11.07.2025, me qëllim shterimin e hetimit administrativ për këtë rast, i është drejtuar sërish Bashkisë Tiranë me kërkesë për sqarim të mëtejshëm, konkretisht lidhur me:

- Afatet zyrtare për shqyrtimin e aplikimeve për mbështetje financiare kulturore sipas thirrjes publike përkatëse.
- Protokollin, rregulloren apo dokument tjetër normativ që përcakton rregullat, ecurinë dhe afatet e trajtimit të aplikimeve të tilla.

Po ashtu, Avokati i Popullit ka kërkuar sqarime specifike lidhur me bazën ligjore, rregullatore apo procedurale në të cilën mbështetet praktikat se *ndryshimi i datës së realizimit të aktivitetit është i pamundur, edhe në rastet kur vonesa në njoftimin e mbështetjes e bën të parealizueshëm aktivitetin në datën e parashikuar nga aplikuesi.*

Lidhur me kërkesën e sipërcituar, nuk pati përgjigje zyrtare nga ana e Bashkisë Tiranë.

Vlerësimi i Avokatit të Popullit

Të drejtat e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë janë të mbrojtura dhe garantuara në mënyrë të gjerë nga një kuadër rregullator kombëtar dhe ndërkombëtar, me qëllim sigurimin e barazisë së plotë në jetën kulturore, sociale dhe publike të vendit, si dhe ruajtjen dhe zhvillimin e identitetit të tyre të dallueshëm.

Në planin ndërkombëtar, Shqipëria është palë në Konventën Kuadër të Këshillit të Europës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtar, e cila kërkon nga shtetet anëtare të marrin masa të përshtatshme për të promovuar kushtet që u mundësojnë pakicave ruajtjen e kulturës, fesë, gjuhës dhe traditave të tyre.

Në nivel kushtetues, neni 20 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë garanton të drejtën e pjesëtarëve të pakicave kombëtare për të shprehur lirisht, ruajtur dhe zhvilluar identitetin e tyre etnik, kulturor, fetar dhe gjuhësor. Ky garantim i barazisë dhe përjashtimi i diskriminimit është themeli mbi të cilin mbështeten edhe aktet ligjore dhe politikat publike.

Ligji nr. 96/2017 “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë” shënon një hap të rëndësishëm drejt standardeve evropiane për njohjen dhe mbrojtjen e të drejtave të pakicave. Neni 11 i këtij ligji garanton të drejtën për pjesëmarrje të barabartë dhe efektive në jetën publike, kulturore, sociale dhe ekonomike, si dhe të drejtën për të përfituar mbështetje financiare nga institucionet e kulturës për ruajtjen dhe promovimin e traditave dhe identitetit të tyre. Po ky ligj, në nenin 12, sanksionon të drejtën e pakicave për të kremtuar ngjarje të rëndësishme për identitetin e tyre kulturor dhe për të zhvilluar aktivitetet që lidhen me trashëgiminë kulturore, gjuhësore dhe fetare.

Në zbatim të ligjit nr. 96/2017 “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”, Këshilli i Ministrave ka miratuar një sërë aktesh nënligjore që garantojnë respektimin, zhvillimin dhe promovimin e të drejtave të pakicave kombëtare në fusha të ndryshme të jetës publike. Këto vendime synojnë të sigurojnë një qasje të barabartë dhe pjesëmarrje efektive të pjesëtarëve të pakicave në jetën kulturore, arsimore dhe sociale të vendit. Ndër më të rëndësishmet, VKM nr. 462, datë 03.07.2019, përqendrohet në masat për sigurimin e pjesëmarrjes së barabartë në jetën publike, kulturore, sociale dhe ekonomike, ku theksohet detyrimi i autoriteteve publike për të mbështetur përfaqësuesit e pakicave, përfshirë financiarisht, përmes projekteve që lidhen me identitetin dhe trashëgiminë e tyre. VKM nr. 463, po e datës 03.07.2019, përcakton detyrimin e ministrive përgjegjëse për kulturën dhe arsimin për të krijuar strategji e programe për promovimin e elementeve themelore të identitetit të pakicave kombëtare. Së fundmi, VKM nr. 769, datë 15.12.2021, i kushtohet posaçërisht kritereve për mbështetjen e projekteve që synojnë ruajtjen dhe zhvillimin e identitetit të pakicave, duke theksuar parimet e trajtimit të barabartë, transparencës dhe konkurrencës së ndershme. Edhe pse ky fond administrohet nga Komiteti për Pakicat Kombëtare, një pjesë e këtyre vendimeve i ngarkojnë pushtetit vendor role aktive, siç parashikohet në VKM nr. 561, datë 29.09.2018 dhe në VKM nr. 1155, datë 24.12.2020, ku njësitë e vetëqeverisjes vendore janë njohur shprehimisht me të drejtën e nismës dhe me përgjegjësi konkrete për krijimin e kushteve për përfshirjen e pakicave kombëtare në jetën arsimore dhe kulturore. Kjo përfshin jo vetëm konsultimin me komunitetet dhe mbështetjen me burime logjistike e financiare për nisma lokale, por edhe rol proaktiv në iniciimin dhe ndjekjen e projekteve që synojnë përfshirjen sociale dhe kulturore të pakicave.

Pavarësisht kërkesës së qartë dhe të drejtpërdrejtë nga Avokati i Popullit për sqarime lidhur me afatet zyrtare të shqyrtimit të aplikimeve për mbështetje financiare kulturore, si dhe për protokollet, rregulloret apo aktet e brendshme që rregullojnë këtë proces, Bashkia Tiranë nuk ka ofruar asnjë përgjigje zyrtare që të adresojë këto çështje themelore të transparencës dhe llogaridhënies. Po ashtu, edhe pyetja specifike mbi bazën ligjore apo procedurale mbi të cilën mbështetet praktika e pamundësisë për të shtyrë datën e realizimit të aktivitetit, nuk ka marrë asnjë shpjegim të detajuar, përkundër rëndësisë që ka kjo në vlerësimin e proporcionalitetit të vendimmarrjes administrative në rrethana konkrete.

Megjithatë, Avokati i Popullit, në vijim të hetimit administrativ, përmes shqyrtimit të informacionit të publikuar në faqen zyrtare të Bashkisë Tiranë (<https://tirana.al/faqe/thirrje-per-aplikime>), vëren se sipas këtij njoftimi, Këshilli Artistiko-Kulturor është organi përgjegjës për shqyrtimin e projekt-propozimeve dhe mblidhet jo më shumë se 12 herë në vit, sipas një kalendarit të paracaktuar që publikohet paraprakisht. Po ashtu, përcaktohet se aplikimet duhet të dorëzohen minimalisht dy muaj përpara datës së zhvillimit të aktivitetit, në mënyrë që të sigurohet koha e nevojshme për shqyrtim, vlerësim dhe miratim brenda afateve të mbledhjeve të Këshillit.

Nga ky këndvështrim, Avokati i Popullit konstaton se, në rastin konkret, Qendra “Laralara” ka paraqitur aplikimin e saj me një afat më të shkurtër se ai i përcaktuar, rreth një muaj para datës së parashikuar të aktivitetit, gjë që e ka vënë procesin në kushte të kufizuara kohore. Kjo tregon nevojë për planifikim më të mirë nga ana e organizatës aplikuese, në mënyrë që proces i aplikimit dhe i shqyrtimit të mos bëhet vetvetiu pengesë. Ndërkohë, duhet theksuar se viti 2025 përkon me shpalljen e Tiranës si “Kryeqyteti Mesdhetar i Kulturës dhe Dialogut”,

një program i gjerë kulturor që përfshin aktivitete, festivale dhe iniciativa që synojnë promovimin e diversitetit kulturor dhe dialogut ndërkulturor në hapësirën euro-mesdhetare.

Megjithëse nuk rezulton se Bashkia Tiranë ka ushtruar diskriminim të drejtpërdrejtë ndaj organizatës ankimuese, Avokati i Popullit nënvizon se grupet e pakicave kombëtare kërkojnë një qasje afirmative (diskriminim pozitiv) nga institucionet publike, për të garantuar barazi reale dhe jo vetëm formale të shanseve për pjesëmarrje. Kjo nuk nënkupton favorizim të pajustificuar, por kujdes të shtuar, udhëzim dhe komunikim të posaçëm për të kapërcyer barrierat që shpesh burojnë nga keqinformimi, stereotipet ose mungesa e kapaciteteve organizative. Për shkak të stereotipeve dhe paragjytimeve që shpesh shoqërojnë perceptimin publik ndaj komuniteteve rome dhe egjiptiane, përfaqësuesit e këtyre grupeve shpesh ndihen të nënvlerësuar dhe të përjashtuar nga proceset institucionale, edhe kur qëllimi i autoriteteve nuk është diskriminues. Kjo ndjesi vjen si pasojë e mungesës së komunikimit të qartë, transparencës së pjesshme dhe pasigurisë në mënyrën se si vlerësohen apo mbështeten iniciativat e tyre. Në këtë kontekst, është detyrë e institucioneve publike, veçanërisht e pushtetit vendor, të tregojnë kujdes të shtuar në mënyrën e komunikimit dhe ndërveprimit me këto komunitete, duke sqaruar rregullat, afatet dhe procedurat në mënyrë të kuptueshme e të ndjeshme, për të shmangur krijimin e perceptimeve të përjashtimit dhe për të ndërtuar një marrëdhënie besimi e bashkëpunimi të qëndrueshëm.

Për këtë arsye, Bashkia Tiranë inkurajohet të tregojë fleksibilitet, ndjeshmëri institucionale dhe komunikim të vazhdueshëm me këto grupe, për t'i ndihmuar në orientimin dhe përgatitjen e aplikimeve në përputhje me afatet dhe kriteret e përcaktuara. Po kështu, do të ishte e dobishme që Bashkia, në publikimin e thirrjeve të saj, të përfshijë qartësisht periodat orientuese se cilat aplikime do të shqyrtohen në secilën mbledhje të Këshillit, duke i dhënë më shumë transparencë dhe qartësi procesit.

Në këtë mënyrë, respektohet një balancë midis nevojës për respektimin e rregullave të përgjithshme të procedurës dhe detyrimit për mbështetje të veçantë ndaj organizatave që përfaqësojnë komunitete të marginalizuara, të cilat shpesh përballen me kufizime burimesh apo mungesë informacioni. Në fund të procesit, qëllimi mbetet që politikat kulturore të Bashkisë Tiranë të jenë gjithëpërfshirëse, duke promovuar barazi reale në akses dhe pjesëmarrje, në përputhje me standardet e Konventës Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare dhe legjislacionin shqiptar në fuqi.

Vendimmarrja për miratim është komunikuar zyrtarisht, megjithëse afër datës së aktivitetit, çka e uli efektin praktik të mbështetjes së dhënë. Kjo situatë ka prodhuar pakënaqësi të komunitetit përfitues dhe, pavarësisht miratimit të fondit, çështja është shtruar pranë Avokatit të Popullit me shqetësimin se rezultati final nuk arriti qëllimin e tij..

Për sa më sipër, bazuar në nenin 1 të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut (*“Të gjitha qëniet njerëzore lindin të lira e të barabarta në dinjitet dhe në të drejta”*), në mbështetje të pikës 3 të nenit 63 të Kushtetutës (*“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”*) dhe në vijim të neneve 2 e 21/b të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, *“Për Avokatin e Popullit”*, i ndryshuar (*“Avokati i Popullit është nxitës i standardeve më të larta të të drejtave dhe lirive të njeriut në vend” dhe “Pas përfundimit të hetimit... paraqet rekomandime për*

vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që, sipas tij, ka shkaktuar shkelje...”),

REKOMANDOJMË:

1. Marrjen e masave nga Bashkia Tiranë, për të garantuar të drejtën për pjesëmarrje të barabartë dhe efektive në jetën kulturore të vendit, si dhe për të përmirësuar mënyrën e trajtimit të aplikimeve nga organizatat që përfaqësojnë komunitete të pakicave kombëtare nëpërmjet zhvillimit të praktikave gjithëpërfshirëse dhe mbështetëse ndaj grupeve të marginalizuara, në mënyrë që të arrihet barazia reale në aksesin ndaj mbështetjes publike dhe të forcohet besimi i komuniteteve në institucionet vendore;
2. Trajtimin me kujdes të veçantë të projekteve që burojnë nga organizata të pakicave kombëtare, duke marrë në konsideratë detyrimin pozitiv të njësive të vetëqeverisjes vendore për të nxitur pjesëmarrjen dhe përfshirjen e këtyre komuniteteve në jetën kulturore dhe publike, në përputhje me ligjin nr. 96/2017 dhe aktet nënligjore zbatuese;
3. Rritjen e transparencës së procesit të aplikimit dhe shqyrtimit, përmes publikimit të qartë në faqen zyrtare të Bashkisë të periudhave orientuese se cilat aplikime do të shqyrtohen në secilën mbledhje të Këshillit;
4. Krijimin e një mekanizmi ankimi ose rishqyrtimi administrativ, që u mundëson aplikantëve të kërkojnë sqarim ose rivlerësim të vendimeve, në rastet kur vlerësojnë se procesi nuk ka qenë i qartë ose proporcional me rrethanat konkrete.

Në përputhje me nenin 22, të Ligjit nr.8454 datë 4.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, plotësuar me Ligjin nr.8600 datë 10.04.2000, ndryshuar me Ligjin nr.9398 datë 12.05.2005, ku përcaktohet se: “*Organet të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar një rekomandim, duhet ta shqyrtojnë rekomandimin dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të rekomandimit*”, lutemi, pas shqyrtimit, të na vini në dijeni për qëndrimin ndaj këtij rekomandimi.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

K O M I S I O N E R E

Vilma SHURDHA

d.v.